# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-476698**
VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | SPAR Albania feston 10 vjetorin duke i ardhur në ndihmë njerëzve në nevojë |
| ADRESA | `https://joq-albania.com/artikull/1394649.html` |
| BURIMI | joq-albania.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 28 shtator 2026, 14:43:52 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 28 shtator 2026, 14:32:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 28 shtator 2026, 14:31:00 UTC → 28 shtator 2026, 14:33:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `ac519ddc4409cabc9569dfa8087aa3624b4b7f44dc01de8b11d6b4308e5b3c06` |
| TEKSTI | `05516c57f85741cd1878e01f2005e42d0441abce5502b674eb0066bdbe8be610` |
| PAMJA | `4c2be1c61478ecb9983cbb5d6c720f5fa504e0d0c348da24e8803447bf52157a` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `94732b314096429ecf611958402100229c671f79ddc165e821c9c29ea0bfb938` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `70759019bbbdb922600e92acf251987d45dad965704b935fe53775a49569cfd8` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/94732b314096429ecf611958402100229c671f79ddc165e821c9c29ea0bfb938`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# SPAR Albania feston 10 vjetorin duke i ardhur në ndihmë njerëzve në nevojë

Shkruar nga: I Cani | Publikuar më: 28.09.2026, 16:32

Share Share




SPAR Albania shënon këtë vit 10-vjetorin e aktivitetit në tregun shqiptar, duke mbyllur një dekadë të karakterizuar nga zgjerimi i vazhdueshëm, investimet dhe një fokus i fortë te nevojat e konsumatorëve.

Që prej hyrjes në treg në vitin 2016, SPAR Albania është shndërruar në një nga rrjetet më të mëdha të tregtisë ushqimore në vend. Sot, kompania numëron **124 dyqane në të gjithë Shqipërinë**, prej të cilave 118 supermarkete SPAR dhe 6 hipermarkete INTERSPAR, me një sipërfaqe totale shitjeje prej rreth 47,500 $m^2$.

Viti 2026 ka qenë një nga periudhat më të rëndësishme të zgjerimit për kompaninë. Gjatë këtij viti janë shtuar 24 pika të reja, përfshirë integrimin e 16 dyqaneve të rrjetit ECO dhe blerjen e aseteve të 6 marketeve KMY. Po ashtu, është inauguruar INTERSPAR Qerret, një hapësirë prej 4,500 $m^2$ që synon të sjellë një eksperiencë moderne blerjeje për konsumatorët.

Përtej zgjerimit të rrjetit, SPAR Albania ka vijuar investimet në modernizimin e dyqaneve, teknologji, kategoritë e produkteve të freskëta dhe zgjerimin e gamës së produkteve, duke synuar më shumë cilësi, zgjedhje dhe vlerë për klientët.

Një vend të rëndësishëm në këtë dekadë zë edhe angazhimi social. Në 9 vite partneritet me **World Vision Albania**, mbi 100 familje nga 19 bashki janë mbështetur me 18.5 tonë ushqime. Ndërkohë, përmes programit "Ndiz një shpresë", mbi 200 fëmijë me aftësi të kufizuara nga 7 bashki kanë përfituar mijëra seanca terapie zhvillimi, fizioterapie dhe logopedie.

Në kuadër të 10-vjetorit, ky angazhim merr një tjetër dimension. SPAR Albania do të kontribuojë me **100.000.000 lekë**, në bashkëpunim me World Vision Albania, për mbështetjen e familjeve në nevojë në Shqipëri.

Gjatë vitit jubilar, SPAR Albania do ta shoqërojë këtë përvjetor me fushata kombëtare, oferta dhe aktivitete të dedikuara për klientët, duke e kthyer 10-vjetorin në një moment festimi së bashku me konsumatorët, punonjësit, furnitorët dhe partnerët.

Duke nisur dekadën e dytë, kompania synon të vijojë zgjerimin e rrjetit SPAR dhe INTERSPAR në të gjithë vendin, duke ruajtur fokusin te cilësia, freskia, shërbimi dhe një eksperiencë sa më moderne për konsumatorët shqiptarë.

**FACT CHECK:** Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e raportoni këtu.

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR



Më të Lexuarat

Aleanca për Media Etike ARTIKULL JOETIK?




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.